



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 6039/ Prot.

Tiranë, më 17.08.2018

Lënda: Dërgim i raportit përfundimtar të auditimit

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"

Gjirokastrë

Nga data 11.06.2018 deri më 30.06.2018, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ka zhvilluar një mision auditimi, në Universitetin "Eqrem Çabej", me objekt "Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime në arritjen e objektivave", për periudhën 01.06.2016 deri më 30.04.2018.


Bashkëlidhur ju dërgojmë,

- Raportin Përfundimtar të auditimit.
- Formularin e plan-veprimit, për realizimin e rekomandimeve.
- Aneksin nr. 2, "Reagim nga subjekti i audituar"

Në zbatim të procedurave ligjore për auditimin e brendshëm, ju kujtojmë se:

- Brenda 30 ditëve, nga marrja e "Raportit Përfundimtar", drejtuesi i institucionit duhet të miratojë "Plan-Veprimin" për zbatimin e rekomandimeve, sipas sugjerimeve të paraqitura në "P/Raport, duke e dërguar atë të nënshkruar në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Në se institucioni i audituar, nuk përgjigjet me shkrim lidhur me pranimin e "Plan veprimit" dhe masat për zbatimin e rekomandimeve, drejtuesi i NjAB-së informon Ministrin që, drejtuesi dhe institucioni i audituar nuk kanë përmbushur përgjegjësitë e tyre ligjore.

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet tuaja për të na ndihmuar, të vlerësojmë performancën tonë personale dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë, duke plotësuar aneksin nr.2, bashkëlidhur.



MINISTËR

Endita Nikolla



RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi

“Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime, në arritjen e objektivave”.

Përmbledhje ekzekutive

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Ministri i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.6039/1.prot datë 11.06.2018

Objekti: -Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime, në arritjen e objektivave

Subjekti i auditimit: Auniversiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë.

Periudha e audituar: 01.06.2016 deri më 30.04.2018

Auditimi ka filluar më: 11.06.2018

Auditimi ka përfunduar: 30.06.2018

Tematika: Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nivelit të riskut

I. Drejtimet kryesore të auditimit:

- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi e mëparëshme.
- Auditim i sistemit të drejtimit dhe strukturës organizative
- Auditim i sistemit të pagave (zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e llogaritjen e pagave)
- Auditim i sistemit për hartimin e zbatimit e buxhetit.
- Auditim i sistemit të prokurimeve të fondeve publike.
- Auditim i sistemit të kontabilitetit financiar.
- Auditim i sistemit për menaxhimin e aktiveve
- Auditim i sistemit për përdorimin e fondeve për bursat.
- Auditim i sistemit mbi krijimin dhe përdorimin e të ardhurave
- Auditim i sistemit të ngarkesave mësimore..

II. Metodologjia:

Studimi i dokumentacionit në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë.

III. Përbërja e grupit të auditimit:

- Skënder Jaku Përgjegjës grupi
- Jeton Shehu Anëtar

Misioni dhe objektivat

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.41, datë 12.11.1991 “Për hapjen e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë ka në përbërje të tij aktualisht tre Fakultete:

1-Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.

I cili në përbërje të tij ka shtatë Njësi bazë (Departamente) të cilat ndahen në 16 grupe mësimore kërkimore.

2-Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

I cili në përbërje të tij ka tre Njësi bazë (Departamente) të cilat ndahen në 6 grupe shkencore –kërkimore.

3-Fakulteti Ekonomik

I cili në përbërje të tij ka tre Njësi bazë (Departamente) të cilat ndahen në 6 grupe mësimore –kërkimore

E detajuar sipas njësive bazë dhe grupeve mësimore për çdo Fakultet është sipas pasqyrës në dosjen e auditimit



Në përfundim të auditimit me shkresën nr.6039/2, datë 09.07.2018 është dërguar projekt raporti i auditit, për të cilin drejtuesit e universitetit nuk kanë reaguar brenda afatit ligjor.

GJETJE DHE KONKLUZIONE:

Grupi i auditit konstatoi se në fushën e veprimtarisë për menaxhimin e burimeve dhe asteve në drejtim të realizimit të objektivave dhe misionit në këtë institucion respektohet kuadri rregullator ne fuqi, megjithë atë u evidentuan fusha që kërkonin përmirësim në të ardhmen, të cilat janë trajtuar në këtë material.

Grupi i auditimit nga dokumentacioni i shqyrtuar evidenton si gjetje dhe konkluzione të rëndësishme sa më poshtë:

1.- Universiteti "Eqerem Çabej", nuk e ka vënë në efikasitet ish godinën e ushtarakëve, kjo për mungesë të fondeve për rikonstruksionin e saj.

Aktualisht kjo ndërtesë ka pësuar ndryshime ku kati i parë me VKM i është dhënë ADISA-s dhe e gjithë pjesa tjetër e godinës është drejt rrënit.

2.- Orët mbi normë mësimore.

Bazuar në udhëzimin nr.20 është paguar mbingarkesa deri në masën 30% të ngarkesës së normuar vjetore. Kjo pagesë është bërë nga të ardhurat e Institucionit.

Në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr.20, sipas vendimit të bordit të administrimit nr.18, datë 15.09.2017 janë paguar punonjësit akademik për tejkalimin e normës së ngarkesës deri në masën 100 %, pa marrë më parë miratimin nga Ministri i Arsimit, siç përcakton udhëzimi.

3.- Në ish shtëpinë e ushtarakëve pronë në përgjegjësi administrave e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë janë dhënë dy ambiente me qira. Kjo në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 16.06.2011, sipas së cilës Ministrisë së Arsimit si përgjegjëse e administrimit të pronës "...i ndalohej të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 (Përdorim për zgjerimin e mjediseve mësimore e studimore...)", ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

Në dy raste ambientet janë dhënë me qira për të tretë si dhe sipërfaqja truall shfrytëzohet pa pagesë nga një qerramarës dhe pjesa tjetër parking i lirë për qytetarët e Gjirokastrës.

4.- Ambienti i dhënë me qira sipas të dhënave të mëposhtme me objekt "Bar Kafe" në ish godinën e ushtarakëve, prej disa vitesh, nga auditimi në vënd rezulton se nuk ka ndonjë objekt në këtë godinë për "Bar kafe"

NR		KONTRATA	QERA MUJORE	Periudha	PËRDORIMI	SIPËRFAQJA
2	Jorgo Llukani	nr 931 prot.dt10.10.2017	11.000	10.10.2017- 09.10.2018	BAR KAFE	100 M2 NDERTESE 50 M2 FUNKSIONALE

5.- Rekomandimi i lënë nga auditimi i mëparshëm për arkëtimin e tarifës së shkollimit është realizuar pjesërisht.

Janë gjithsej pa paguar 153 studentë të bachelorit me një vlerë prej 3.654.500 lekë

Përkatesisht :

Në Fakultetin Ekonomik që nuk kanë paguar tarifën janë 66 studentë në shumën 1.502.500 lekë

Në F.E.SH.SH janë 39 studentë me vlerë prej 1.142.500 lekë

Në FSH.N janë pa paguar 48 studentë me një shumë prej 1.009.500 lekë.

6.- Për periudhën e audituar është vënë re fakti se nuk mbahet parasysh evidentimi i gjendjes së aktiveve të konstatuara, të dëmtuara dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit të hartohet ku në



përfundim të përpilophej një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve dhe t'i dorëzohet për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues, si dhe të përgatitet relacioni për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, ku të sqarohen arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

7.- Për periudhën e audituar si në vitin 2016 dhe në vitin 2017 fondet e parashikuara për investime janë realizuar në përqindje shumë të ulta e konkretisht për vitin 2016 42 % dhe vitin 2017 vetëm 5.3 %

1.- MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA AUDITIMET E MËPARËSHME.

Në Universitetin "Eqrem Çabej" nga data 20.06.2016 deri më 01.07.2016 është ushtruar një auditim i përgjithshëm nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit mbi rregullshmërinë financiare për periudhën 01.01.2013 deri në 31.05.2016.

Në përfundim të auditimit është hartuar raporti final dhe me shkresat nr. 6152/4 prot., datë 08.11.2016 dhe nr 946/1 prot., datë 10.11.2016 janë përcjellë në Universitetin "Eqrem Çabej" rekomandimet dhe masat për realizimin e tyre, si më poshtë:

1-Të rishikohet sistemi i kontrollit të brendshëm për arkëtimin e tarifave duke bërë të mundur që asnjë student të mos arrijë të mbyllë vitin akademik 2016-2017 pa arkëtuar më parë tarifën e shkollimit ,duke ngritur grupe pune për ndjekjen e arkëtimin të tarifës së shkollimit në mënyrë periodike .

2-Sistemin e kontrollit lidhur me pagesat për punë "jashtë kohës normale" të punës " në mbështetje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr .16 datë 20.07.2011

3-të merren masa e të ndiqen procedurat në rrugë ligjore për arkëtimin e detyrimit 26.334.578 lekë, tarifë shkollimi

1-Në zbatim të rekomandimit të parë, Universiteti "Eqrem Çabej" me shkresën nr.972 prot. të datës 15.11.2016 "Për zbatimin dhe ndjekjen e arkëtimin të tarifës së shkollimit" ka njoftuar Drejtorinë Ekonomike Kryesekretaret e Fakulteteve, Sekretaret mësimore si edhe Dekanët e Fakulteteve dhe specialistët e IT-së në lidhje me zbatimin dhe ndjekjen e arkëtimeve sipas afateve të përcaktuara në shkresën nr 908.prot.datë 03.11.2016 "Për zbatimin e tarifave të Shërbimeve që ofron Universiteti ynë ,sipas vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 11 datë 28.10.2016 e nr. 882.Prot datë 28.10.2016. Grupet e punës të ngritura me këtë urdhër kanë kryer kontrole të herëpashershme sidomos gjatë sezonit të provimeve dhe kanë informuar kancelaren në lidhje me këtë problematikë. Me shkresën nr. 1318 Prot. datë 22.11.2017 të Administratorit pas miratimit nga Bordi i Administrimit janë përcaktuar tarifat e shkollimit dhe afatet e pagesave për vitin akademik 2017-2018 .

Realizimi i të ardhura nga tarifat që nuk ishin realizuar deri ne 30.06.2016.

1. Për sistemi bachelor me kohe te plote janë realizuar nga tarifat e pa arkëtuara 670.414 leke nga 2.655.812 leke që nuk ishin realizuar në 30.06.2016 dhe nuk janë arkëtuar akoma 1.985.398 që u përkasin 88 studenteve që nuk kanë frekuentuar mësimin.
2. Për sistemin partajm janë realizuar nga tarifat e pa arkëtuara 1.838.743 lekë nga 2.136.616 leke që nuk ishin realizuar ne 30.06.2016 dhe nuk jane realizuar akoma 297.873 leke qe u përkasin 7 studenteve qe nuk kane frekuentuar mësimin, por theksojmë se sistemi part-time aktualisht është mbyllur dhe këto studentë që janë larguar mbeten si debitorë me mundësi të vogël arkëtimi.
3. Për sistemin master profesional dhe shkencor periudha 2015-2016 janë realizuar nga tarifat e pa arkëtuara 13.577.005 leke nga 19.074.150 leke që nuk ishin realizuar në 30.06.2016 dhe nuk



janë realizuar akoma 5.497.145 leke që u përkasin 64 studenteve që nuk kanë frekuentuar mësimin.

Per sistemin master profesional dhe shkencor periudha 2014-2015 kesti i trete janë arkëtuar nga tarifa lekë 538.400 nga 2.486.000 leke që nuk ishin realizuar në 30.06.2016 dhe nuk janë arkëtuar akoma 1.929.600 lekë që u përkasin studentëve që nuk kanë frekuentuar dhe nuk janë diplomuar .

2-Në lidhje me problemin e sistemit të kontrollit lidhur me pagesat për punë "Jashtë kohës normale të punës" në mbështetje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr .16 datë 20.07.2011,në vazhdimësi në Universitetin "Eqrem Çabej"Gjirokastrë , është bërë pagesa për orët jashtë kohës normale për rregjistrimet e studentëve në vlerën 357.456 lekë në muajin tetor me pagat e muajit shtator si për punonjësit mbështetës edhe punonjës të tjerë sipas grupeve të punës të ngritura për rregjistrimin e studentëve.

Me ardhjen e raportit final të Auditit të Ministrisë më datën 10.11.2016 ka dalë urdhëri nr 793 datë 07.10.2016 "Për punën jashtë kohës normale dhe në ditët e pushimit javor "

Titullari ka nxjerrë urdhrin nr 820 Prot. Datë13.10.2016 "Për kthim pagesash të padetyruara"dhe këto lekë janë kthyer përsëri pasi u mbajt proces verbal me secilin nga punonjësit, duke u mbajtur nga paga sipas deklaratës së personave.

2.- AUDITIM I SISTEMIT TË DREJTIMIT DHE STRKTURËS ORGANIZATIVE

Struktura analitike aktuale e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë paraqitet sipas pasqyrës në dosje Struktura është miratuar me vendim të Bordit të Administrimit.

Struktura e rektoratit 2018

I. DREJTORIA E SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE-ADMINISTRATIVE

Drejtor Drejtorie	1 (një)
-------------------	---------

A. SEKTORI JURIDIK, BURIMEVE NJERZORE DHE SHËRBIMEVE BIBLIOTEKARE

<i>Shërbimet juridike, të personelit dhe sekretari-arkiv</i>	
Përgjegjës sektori	1 (një)
Specialist i zyrës juridike	1 (një)
Specialist i burimeve njerëzore dhe statistik-informacionit Rektorat	1 (një)
Asistent specialiste e Rektorit dhe sekretaree senatit akademik	1 (një)
Specialist i arkiv-protokolli Rektorat	1 (një)
K/sekretare mësimore e institucionit	1 (një)
Specialist i marrëdhënjeve me publikun	1 (një)
Specialist për rregullimin e marrëdhënjeve institucion-student	1 (një)
<i>Shërbimet bibliotekare</i>	
Kryebibliotekar	1 (një)
Specialist klasifikator	1 (një)



Bibliotekar	1 (një)
Gjithësj	11

A. SEKTORI I STANDARTEVE DHE KORRIKULAVE

<i>Korrikulat dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë</i>	
Përgjegjës sektori	1 (një)
Specialist i standartëve të cilësisë dhe vlerësimit institucional	1 (një)
Specialist për mësimin dhe korrikulat	1 (një)
Specialist i këshillimit të karrierës	1 (një)
Specialist i ALUMNI-it dhe formimit të vazhduar	1 (një)
<i>Teknologjia e informacionit</i>	
Specialist për TI	1 (një)
Specialist i rrjetit informatik	1 (një)
Specialist i faqes elektronike të universitetit	1 (një)
Gjithsej	8 (tetë)

B. SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE MARRËDHËNJEVE ME JASHTË

Përgjegjës sektori	1 (një)
Specialist për menaxhimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore	1 (një)
Specialist i protokollit për marrëdhënjeve me jashtë	1 (një)
Specialist për projekte	1 (një)
Gjithsej	4 (katër)

A. Për Procedurën e Punesimit të Personelit Administrativ zbatohen nenet 49, 57, 67 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" neni 28, 40, 48

Punësimi i personelit administrativ në universitetin tonë si Institucion Publik të Arsimit të Lartë bëhet me konkurs publik. Kriteret e punësimit përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e Brendshme të Institucionit më poshtë janë të përcaktuar hapat që ndiqen nga UGJ.

Përpara hyrjes në fuqi të udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017 "Për stukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet e Arsimit të Lartë pika 7 " procedurën e punësimit për personelin administrativ e ndiqte Rektori pas hyrjes në fuqi të këtijë udhëzimi proceuren e ndjek Atministratori.

1. Caktimi i kriterëve të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë hartohen nga Rektori në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me nenin 48 të Statutit të UGJ-së.



Njoftimi i konkursit publik se bashku me kriteret, percillen per botim ne Buletinin e Njoftimeve Publike të nenshkuar nga titullari i së cilës është pozicioni vakant, ne forme elektronike dhe te shkruar.

3. Pas shpalljessë Njoftimit në Buletinin e Njoftimeve Publike Administratori, nxjerr urdhrin për caktimin e anëtarëve në komisionin ad hoc të shqyrtimit dhe vlerësimit të kandidaturave për pozicionin e kërkuar, në zbatim të udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017 " Për stukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet e Arsimit të Lartë pika 7 ".
4. Komisioni i Vlerësimit perpara hyrjes në fuqi të udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017 kryesohej nga Administratori dhe dy anëtarë të tjerë personel administrativ, ndersa renditja e kandidatëve i përcillej Rektorit, i cili shpallte fitues kandidatin e renditur të parin. Tashmë me ndryshimet përkatëse komisioni urdhërohet nga titullari i vendi vakant, komisioni ad hoc përmban 3 anëtarë të cilët pasi bëjnë vlerësim të dosjeve të aplikanteve ia përcjellin për miratim.
5. Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues Titullari nxjerr urdhrin " Për emërim në detyrë "

-Trainimi i stafit për pozicionet e punës që ato kryejnë

-Për stafin akademik na ana e DSHNA nuk ka një program të dedikuar trainimi, pasi ky personel ndjek një proces të pavarur personal kualifikimi sipas kërkesave të karisrës studimore pedagogjike .Nga pikpamja e tematikës dhe vlerësimit të punimeve të Doktoraturave dhe të niveleve të tjera akademike problemet kalojnë nëpërmjet strukturave përkatëse akademike.

-Kjo drejtori për profesoratin bën regjistrimin sistematik të ndryshimeve që bëhen për këtë kategori të punonjësve akademik. (titujt, gradat) etj.

-Pedagogët e rinj dhe stafi ndihmës trajnohen në momentin para fillimit të punës për ti njohur me rregullat administrative, kërkesat e vendit të punës dhe me marrëdhëniet e varësisë në institucion aty ata kanë.

-Vazhdueshmëria në përshkrimin e vendit të punës.

-Përshkrimi i vendit të punës është bërë fillimisht në Rregulloren e Brendshme të institucionit. Pas rekrutimit të punonjësve të rinj nga komisionet ad-hoc për personelin akademik dhe administrativ, u bëhet njohja e tyre me kërkesat e përcaktuara për çdo pozicion.

-Në vijueshmëri bëhen ndryshime nga sturukturat përkatëse në përshkrimin e pozicioneve dhe këto u bëhen të njohura punonjësve.

Punësimi realizohet me procedurë të konkurimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.

Ka përputhje të kriterëve profesionale me kërkesat e vendit të punës për punonjësit aktualë dhe punësimet e reja

Stafi i universitetit nuk a trajnohet për pozicionet e punës që ata kryejnë;

Nuk ka vazhdueshmëri në përshkrimin e vendit të punës;

Bëhet në vijimësi vlerësimi i performancës së punonjësve;

Ka harminizim të burimeve njerëzore ekzistuese me prurjet e reja;

Rekrutimi personelit akademik në departamentet e fakulteteve të UE-së është kryer në zbatim të strukturës së miratuar si dhe Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin nr 21 datë 14.06.2012 të Senatit të UE "Miratimin e ndryshimeve të modaliteteve dhe standardeve të rekrutimit të personelit akademik".

Janë ndjekur hapat që nga kërkesa e departamentit deri në lidhjen e kontratës së punës.

3.- AUDITIM I SISTEMIT TË PAGAVE (ZBATIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE NË LOGARITJEN E DHENIEN E PAGAVE)

Në fushën e pagavë janë zbatuar dispozitat ligjore për mardhëniet e punës dhe të pagave me përjashtim të pagesës për përgjegjësit e sektorëve.



Sistemi i listë pagesave është në përputhje me legjislacionin në fuqi janë zbatuar dispozitat ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Listë-prezencat, rishikohen, miratohen, përpunohen, dokumentohen dhe regjistrohen qartë. Orët e punës së personelit, personat që largohen, pagat dhe ndalesat e pagave janë autorizuar siç duhet. Të gjitha pagesat janë bërë në kohë. Pagesat janë regjistruar në vlerën e duhur. Nga mbledhja aritmetikore e listë pagesave rezulton se nuk ka gabime. Përmbledhësja e listë pagesës është në shumë të barabartë me shumën e urdhër shpenzimeve. Përmbledhëse e liste pagesës në çdo rast ka firmën dhe vulën e degës së thesarit në rreth. Listë pagesat në çdo rast janë të shoqëruara me listë prezencat dhe janë plotësuar sipas rregullave në fuqi. Nga auditimi me zgjedhje në disa listë pagesa rezulton se janë llogaritur saktë ndalesat për sigurime shoqërore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.

4.- AUDITIM I SISTEMIT PËR HARTIMIN E ZBATIMIN E BUXHETIT

Në lidhje me këtë çështje të programit të auditimit u bë një auditim mbi përputhshmërinë dhe zbatimin e ligjshmërisë për transaksionet financiare në veprimtarinë ekonomike financiare të rektoratit dhe njësive shpenzuese të saj.

Për gjithë veprimtari në financiare, planifikuar në buxhet, Universiteti është referuar ligjeve dhe udhëzimeve, si më poshtë:

Ligjin 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë",

Ligji nr.130/2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017",

Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar,

Ligji nr.48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare",

Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë",

Statutin e Universitetit

VKM Nr. 550 datë 11.08.2011 "Për disa Ndryshime në vendimin nr.748 datë 11.06.2009, të ndryshuar me VKM nr 268 datë 29.03.2017, VKM Nr.524 datë 16.08.2012 "Për miratimin e Strukturës dhe nivelit të pagave në aparatet e Ministrisë së Linjes", ndryshuar me VKM nr 187 datë 08/03/2017. VKM Nr.690 datë 09/10/2012 "Për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore, i ndryshuar, me VKM nr 202 datë 15.03.2017. VKM Nr. 997 datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, me ndryshime. Udhëzimi Nr.20 datë 09/05/2008 "Për personelin akademik në IAL" i ndryshuar me udhëzimin Nr.25, datë 02/08/2010 si dhe udhëzimi numër 40 datë 08/12/2009,

REALIZIMI I BUXHETIT VITI 2016

Nr.	Emërtesa	Plani Viti 2016	Realizimi Viti 2016	% e Realizimit me planin fillestar
1	Fondi i pagave	246.400.000	201.270.298	82%
2	Sigurime shoqërore	30.201.000	28.204.402	93%
3	Shpenzime operative	36.716.000	31.615.337	86%
4	Bursa	8.000.000	7.260.885	90%
5	Investime	17.353.512	7.252.306	42%
6	Transferta me jashte	400.000	247.530	62%
	Gjithsej shpenzime	339.070.512	275.850.758	81%

Si shihet nga tabela realizimi i fondeve është jo i plotë pasi faktorët që ndikuan në mosrealizimin e fondeve ishte mosdalja e akteve nenligjore në zbatim të ligjit të arsimit të lartë pasi :

1. nuk u miratua asnjë strukturë e re shtesë (Administrator Universiteti e Fakulteti)
2. nuk u miratua asnjë Departament në Fakultetin Ekonomik nga MAS
3. mosveprimi i Departamenteve të cilat kanë planifikuar aktivitete të ndryshme shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe nuk kanë realizuar asnjë të tillë përgjatë vitit 2016.
4. nuk është bërë asnjë pagesë për orët mbi kohën normale të punës, të cilat zinin një pjesë të konsiderueshme në buxhetin e të ardhurave, të detyruar nga gjendja reale e arkëtimit të të ardhurave të institucionit.

Për zërin e investimeve dhe studime e projekte, nuk është realizuar një pjesë e objekteve të planifikuara si:

1. Blerje paisje për Laboratorin e Elektronikës dhe Elektromagnetizmit
 2. Blerje paisje për Laboratorin e Biologjisë
 3. Blerje paisje për Laboratorin e Mekanik dhe Termodinamikës
- etj.

Për zërin Supervizim Kolaudim kemi mosrealizim, pasi kontrata për këto shërbime është planifikuar në varësi të fondit limit fillestar të realimit të rikonstruksionit të nyjeve.

REALIZIMI I BUXHETIT VITI 2017

Nr.	Emërtesa	Plani Viti 2017	Realizimi Viti 2017	% e Realizimit me planin fillestar
1	Fondi i pagave	232.887.104	208.507.843	90%
2	Sigurime shoqërore	31.570.000	29.852.453	95%
3	Shpenzime operative	42.200.000	28.965.872	69%
4	Bursa	8.000.000	7.081.725	89%
5	Investime	12.318.400	646.800	5.3 %
6	Studime projekte	2.961.600	198.342	6.7 %
7	Transferta me jashtë	1.000.000	488.090	49%
	Gjithsej shpenzime	330.937.104	275.741.125	83.3%

Buxheti për vitin 2017 është miratuar me vendimin e bordit të administrimit nr.3. datë 25.01.2017.

Për vitin 2017

Sic shihet edhe nga tabela ka fond të papërdorur si për pagat edhe për sigurimet shoqërore në vlerë jo të vogël për arsye se në muajin tetor 2017 u akordua shtesë fondi në vlerën 14.457.104 lekë, për efektet financiare që rrjedhin nga hyrja në fuqi i vkm nr Ndryshimet e fundit të pagave janë bërë në vitin 2017 për punonjësit e administratës me pagë grupi sipas shkresës së ardhur në zyrën e financës më datë 30.03.2017 Nr.327. Prot në mbështetje të V.K.M Nr.187, datë 08.03.2017 në të cilën janë specifikuar pagat në bazë të pozicionit sipas kategorisë së pagës së grupit dhe shtesës së pozicionit. Ndryshimet e fundit të pagave për punonjësit me klasa janë bërë në vitin 2017 sipas shkresës së ardhur në financë më datë 30.03.2017 Nr.328. Prot. në mbështetje të V.K.M Nr.202, datë 15.03.2017 në të cilën janë specifikuar pagat në bazë të pozicionit sipas klasave. Ndryshimet e fundit të pagave për personelin akademik janë bërë në vitin 2017 sipas shkresës së ardhur në zyrën e financës më datë 04.04.2017 Nr.345. Prot. në mbështetje të V.K.M Nr. 268, datë 04.04.2017 në të cilën janë specifikuar pagat në bazë të pozicionit dhe titullit dhe cdo pedagog.

Nga fondi i pagave gjatë vitit janë dhënë shpërblime për rast fatkeqësie e sëmundje në vlerën prej 754.638 lekë si edhe për dalje në pension duke alokuar fondet nga pagat tek pagesa për raste të vecanta.



Plani i limitit të përdorimit nga të ardhurat dytësore për vitin 2017 në total është 55.984.000 lekë, nga i cili është realizuar në vlerën 24.669.040 lekë, përfshirë ndryshimet e herëpashërëshme (të cilat janë miratuar rast pas rasti nga Bordi i Administrimit) ku të detajuar sipas artikujve të shpenzimeve i analizojmë më poshtë:

Sic shihet nga Tabela e Realizimit të buxhetit, në përgjithësi ka zëra me mosrealizime, që kryesisht janë nga mosplanifikimi i saktë i fondit të tyre që në fillim të vitit. Për këtë arsye kërkohet nga Departamentet që në të ardhmen kërkesat e tyre të jenë të mirëstudiuara dhe reale.

Ka një realizim të konsiderueshëm tek zërat e shpenzimeve të Telefonit dhe Energjisë, ku vitet e tjera kemi patur më shumë shpenzime dhe prandaj është planifikuar më shumë në fillim të vitit. Gjatë vitit 2017 është hequr totalisht furnizimi me energji elektrike të objektit të Ish-Shtëpisë së Ushtarakëve, ambienteve të dhëna me qera u është kërkuar lidhja e kontratës së furnizimit me energji të bëhet nga vetë qeramarrësit, si dhe janë ulur në vlerë të konsiderueshme shpenzimet si ato telefonike statike në zyrat e universitetit ashtu edhe të shpenzimeve të telefonisë celulare. Në lidhje me furnizimin e institucionit me ujë, është bërë instalimi i matësit të ujit, duke minimizuar faturën mujore të këtij shërbimi. Në zërat e tjerë ka mos realizime pjesore për arsye të vlerave të ulëta gjatë prokurimit, por që janë bërë rialokimet e tyre në zërat ku kishim më shumë nevojë. Për arsye se të gjitha shpenzimet për funksionimin e institucionit përballohen si nga të ardhurat dytësore të Universitetit ashtu edhe nga granti, ishin planifikuar në vlera të ulëta sipas nevojave reale, me qëllim grumbullimin e të ardhurave dhe përdorimin e tyre për shpenzime më të domosdoshme në funksion të procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Një mosrealizim i konsiderueshëm është në zërin Kosto reklamimi dhe publikime e buletine, pasi nga Fakultetet nuk u paraqit asnjë material për botimin e ndonjë buletini "Kërkime Universitare", nga katër të planifikuar cdo vit buxhetor të mëparshëm. Mosrealizim kemi edhe në zërat Shpenzime për Konferencat, Aktivitete Shkencore të Departamenteve, duke përmendur zhvillimin e 2(dy) konferencave ndërkombëtare, një aktivitet për Profesorin Thoma Dhima si edhe për Akademikun Jorgo Bullo, pavarësisht se ishte e planifikuar cdo kërkesë e Departamenteve për zhvillimin e konferencave apo aktiviteteve të tjera.

III- Financimi për Investime dhe Studime Projektme.

a) Në zërin e investimeve ka një realizim prej 5.3 % të të ardhurave të parashikuara. Kjo ka ardhur si rezultat i realizimit të prokurimeve në një vlerë më të ulët se ajo e planifikuar nga specialistët tanë. Për vitin 2017 ka mosrealizim edhe për shkak të anulimit të procedurave të prokurimeve publike për një periudhë si dhe për arsye të anulimit të 2(dy) prokurimeve. Por objektet e tjera, të cilat janë miratuar gjatë vitit 2017 në BA-në e Universitetit dhe nuk janë realizuar.

b) Në zërin Studime Projektme ka realizim prej 6.7 %, ku është bërë planifikimi për pagesën prej 40% e projektit të objektit "Rishikimi i projektit të shtëpisë së Ushtarakëve", pasi një pjesë e saj u kalua në administrim të Adisë-s dhe sipas legjislacionit në fuqi mund të bëhet rishikim projekti në masën 40% të projektit fillestar. Por duke qenë se zëri studime projektme është i lidhur me zërin investime rrjedhimisht edhe ky zë është realizuar në këtë masë kaq të ulët.

STUDIME PROJEKTIME DHE INVESTIME

Studime projektme e investime		Planifikuar	Realizuar
1	Studime projektme leje ndertimi	561.600	198.342
2	Supervizion kolaudim	218.400	
	Rishikim i projektit të shtëpisë së ushtarakeve	2.400.000	
3	Rikonstruksion i nyjeve hidro sanitare	6.500.000	
4	Paisje kompjuterike e elektrike	2.000.000	



5	Paisje zyre mobileri	800.000	646.800
6	Mjete didaktike harta lab.gjeografise	800.000	
7	Libra per bibliotekën	2.000.000	
	Totali	15.280.000	845.142

Për zërin transferata me jashtë shtetit për abonime në revista të huaja është planifikuar 1.000.000 por nuk na kanë ardhur kërkesat për realizimin nga departamentet dhe në vazhdim kemi planifikuar më pak fonde.

5.- AUDITIM I SISTEMIT TË PROKURIMEVE TË FONDEVE PUBLIKE

Në mënyra analitike procedurat e zhvilluara për prokurimet në periudhën qershor 2016 – prill 2018 sipas pasqyrës, pjesë e dosjes së auditimit:

Objekt i prokurimit Blerje paisje Zyre Urdhër I prokurimit nr 407/25.05.2016 fondi limit 3.333.333 lekë pa tvsh lloji I procedurës Kerkese për propozim ne perputhje me nenin 34 te Ligjit 9643 datë 20.11.2006 Per prokurimin public I ndryshuar dhe nenin 39 te VKM NR 614 DATË 29.12.2014”Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar u paraqitën dy operatorë ekonomike qe sipas proces verbalit të datës 10.06.2016 jane AI medical dhe Ferit Myftari sipas shqyrtimit te dokumentacionit eshte shpallur fitues ferit myftarime process verbalin e datës 14.09.2016, por nuk arriti të përmbushë detyrimet e kontratës Nr 802Prot datë 12.10.2016 dhe sipas process verbalit nr 1120/1 datë 19.12.2016 u zgjidh kontrata me shkresën nr 1120/2 datë 19.12.2016 dhe shoqëria intersig duhet të ktheje sigurimin e kontrates prej 358.400 lekë Brenda 15 diteve .

Objekti i prokurimit Blerje libra Urdheri I prokurimit nr 619 date 27.07.2016 me fond limit 2.000.000 lekë pa tvsh lloji I procedures kerkese per propozim .U paraqiten dy operatore ekonomike sipas loteve „per lotin e pare dhe te treteë kurse për lotin e dytë libra për matematke informatike –ekonomik nuk u paraqit asnje operatore.U mbajt process verbali me daten 12.08.2016 ku u bë klasifikimi I operatorit Naim Zoto per lotin e pare me oferte 1.387.798 lekë pa tvsh si dhe I operatorit Adrion për lotin e tretë me oferte 246.116 lekë pa tvsh.Më datën 04.10.2016 u be anullimi I lotit të parë gjeografi –histori –letersi se u konstatua nje gabim ne preventivin e derguar me shkrese te brendshme nr 27 prot I brend date 22.07.2016.kontrata u lidh me operatorin Adrion me nr 745 prot date 28.09.2016.

Objekti I prokurimit Blerje materiale elektrike hidraulike ndertimiUrdheri I prokurimit nr 533prot date 29.06.2016 me fond limit 833.333 leke pa tvsh dhe lloji I procedurës kerkese për propozim . me daten 15.07.2016 kvo mbajti proces verbalinku u paraqitën katër subjekte për konkurim Subjektet janë “Konstruksion 04”,”Ferit Myftari “Orea “shpk dhe “Ymer Mullai” ku cmimin më të ulët me ofertë anomalisht të ulët u paraqit orea shpk ,me vleren 541.247 leke . Komisioni I kërkoi argumenta për realizimin e procedures deri me daten 22.07.2016.Me datën 21.07.2016 orea solli informacionin e kerkuar nga kvo dhe me datën 22.07.2016 mbajti nje process verbal ku pranoi argumentat e subjektit dhe vendosi kualifikimn e orea s .lidhje e kontratës u krye me nr 636 prot me datën 24.08.2016

Objekti I prokurimit Blerje kancelari qe u zhvillua me datën 29.07.2016 u kontaktua me të gjithë pjesmarrësit nuk plotesojne kriteret e kualifikimit neë mbështetje të nenit 24 pika 1 e ligjit nr 9643 date 20.11.2006 “per prokuroimin publik“ të ndryshuar vendoset anullimi I tenderte me shkresen date 04.08.2016.

Objekti i prokurimit Blerje libra Urdheri I prokurimit nr 776 date 05.10.2016 me fond limit 1.749.670 lekë pa tvsh lloji I procedures kerkese per propozim .U paraqiten nje operatore ekonomike per lotin e pare,por qe nuk plotesonte dokumentat teknik e per rrjedhoje nuk u



kualifikua kurse për lotin e dytë libra për matematikë informatike –ekonomik nuk u paraqit perseri asnje operatore.

Objekti I prokurimit Blerje kancelari ,bojra shtypshkrime urdheri I prokurimit nr 638 prot datë 04.08.2016 me fond limit 2.083.333 leke pa tvsh lloji I procedures kerkese per propozim.u paraqiten pesë operatore ekonomike kjo sipas process verbalit date 19.08.2016 te mbajtur nga KVO ja per hapjen e procedures dhe vleresimin ne sistem deri me daten 22.08.2016.Pjesmarres por që nuk u kualifikuan per shkak te mungesave ne dokumentat teknik ishin operatorët :Colombo,Lorenc Lazo ,Infosoft Office ,Ferit Myftari.Kontrata u lidh me nr 685 Prot me daten 09.09.2016

Objekti i prokurimit Blerje libra Urdheri I prokurimit nr 871 date 27.10.2016 me fond limit 1.749.670 lekë pa tvsh lloji I procedures kerkese per propozim .U paraqiten nje operatore ekonomike Naim Zoto per lotin e pare ne vleren 1.416.120 leke , u kualifikua me oferte të paraqitu prej 1.387.798 lekë , kurse për lotin e dytë libra për matematikë informatike –ekonomik nuk u paraqit përsëri asnjë operator.Me operatorin Naim Zoto u lidh kontrata me nr 1036 Prot datë 30.11.2016

Per vitin 2017

Objekti i prokurimit Blerje karburant Urdheri I prokurimit nr 95 datë 02.02.2017 me fond limit 3.333.333leke pa tvsh me dy lote blerje gazoil 2.250.000leke loti I pare dhe blerje benzine super pa plumb 1.083.333lekë lloji I procedures kerkese per propozim .U paraqiten tre operatore flady petroleum ,eroil +das , Kastrati .Nga te tre ofertuesit rezulton se vetem flady petroleum është kualifikuar sipas process verbalit te K V O date 22.02.2017 dhe hyrjes ne system me daten 23.02.2017.Me daten 06.03.2017 I paraqet titullarit raportin përmbledhes .Me nr 263 prot datën 15.03.2017 u lidh kontrata per furnizim me mallrat deri me daten 31.12.2017

Objekti i prokurimit Riparim mjete transporti Urdheri I prokurimit nr 384 datë 13.04.2017 me fond limit 833.333leke pa tvsh .U paraqiten dy operatore flady petroleum dhe AE GRUP ,SIPAS PROCES VERBALIT 02.05.2017e raportit përmbledhes të datës 11.05.2017ku flady petroleum kishte oferten 778.500 lekë pa tvsh ose 934.200 lekë me tvsh .lidhja e kontrates u krye me nr 518 prot më daten 01.06.2017 .

Objekti i prokurimit Sherbim me roje civile Urdheri I prokurimit nr 62 datë 26.01.2017 me fond limit 4583333leke pa tvsh .U paraqiten kater operatore ekonomike anaconda anaconda secyruti ,nazeri 2000 dhe grup -4 saipas process verbalit date 10.02.2017ku tre nga operatorët ishin me te njejten oferte kurse operatori I katert grup -4 u skualifikua se oferta eshte nen koston e lejuar .u be njoftimi I tyre me shkresen nr 238 date 06.03.2017 hedhja e shortit me procedure ku fitues ishte Anakonda Lidhja e kontratës u bë me datën 28.03.2017 me nr 316 në vlerën për 2017 prej 4.079.264lekë.

Objekti I prokurimit Blerje kancelari ,bojra shtypshkrime urdheri I prokurimit nr 906 prot datë 04.10.2017 me fond limit 2.083.333 leke pa tvsh lloji I procedures kerkese per propozim .U paraqiten pesë operatore ekonomike kjo sipas process verbalit date 19.08.2016 te mbajtur nga KVO ja per hapjen e procedures dhe vleresimin ne sistem deri me daten 22.08.2016.Pjesmarres por që nuk u kualifikuan per shkak te mungesave ne dokumentat teknik ishin operatorët :Colombo,Lorenc Lazo ,Infosoft Office ,Ferit Myftari.Kontrata u lidh me nr 685 Prot me daten 09.09.2016

OBJEKTII PROKURIMIT;Mirëmbajtje e Murit Rrethues dhe Kanalizim i Ujrave të Batajës Me urdher prokurimi Nr 264prot,date 27.02.2018,Me fond limit 1.599.838 Më datën 12.03.2018 , ora 10:00, ne Universitetin “ Eqrem Çabej”, u zhvillua tenderi me mjete elektronike me procedure



Kerkese per propozim" Punet ,me objekt "Mirëmbajtje e Murit Rrethues dhe Kanalizim i Ujrave të Bardha" me fond limit 1 599 838 (nje milion e peseqind e nentedhjet e nente mije e teteqind e tridhjet e tete) leke pa TVSHfinancuar nga të ardhurat dhe buxheti i shtetit .Kishin dorezuar oferta ne menyre elektronike operatoret e meposhtem: ColomboSarkErgidhe Kadia. TEA-DKomisioni i vleresimit te ofertave me Vendim Nr 400 datë 30.03.2018 bëri rivlerësim duke skualifikuar OE KADIA për paraqitjen e një vërtetimi jo të vlefshëm.Ne baze te kriterit te vleresimit te perzgjedhur " cmimi me i ulet i ofertave te kualifikuara "OE TEA-D me vlerë të ofruar e ofertes1 572 221 (një milion e pesëqind e shtatëdhjet e dy mijë e dyqind e njëzet e një) leke pa TVSH.Kontrata u lidhe me nr 489 date16.04.2018 ,me vlerën prej 1.886.665 leke me TVSH.

OBJEKTI PROKURIMIT ; "Shërbim Ruajtje Objekti me roje private për Universitetin Eqrem Çabej, 2018"Urdhri I prokurimit nr 142prot ,datë 06.02.2018.Me fond limit 5.127.674 lekë me procedure "Kerkese per propozim" "Shërbim Ruajtje Objekti me Roje Private për Universitetin Eqrem Çabej, 2018" – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 10 muaj e 5 ditë –financuar nga buxheti i shtetit Fondi i Marrveshjes Kuader 5 127 674.08 (pesë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjet e katër presje zero tetë) leke pa TVSH.Datë e zhvillimit të tenderit u caktuar data 19.02.2018 ora 14.00. Kishin dorezuar oferta ne menyre elektronike operatoret e meposhtem: "Anakonda", "Anakonda Security" shpk,"NAZERI 2000" ,"Grup 4" shpk.Pasi Operatorët ekonomik morën njoftimin mbi klasifikimin nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit, në zbatim të Ligjit "Për prokurimin Publik" me të gjitha ndryshimet, pranë Autoritetit tonë Kontraktor është paraqitur: Ankesë nga "Grup 4" shpk në formë shkresore me formularin e ankesës protokolluar me tonën Nr. 278 Prot, datë 02.03.2018.Ankesë nga "Anakonda" Shpk në formë shkresore me formularin e ankesës protokolluar me tonën Nr. 288 Prot, datë 02.03.2018.Ankesat konsistojnë në kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave për kualifikimin e tre ofertave të tjera garuese në këtë procedurë konkurimi.Me Urdhër Nr.298 Prot, datë 02.03.2018 është pezulluar procedura e prokurimit me objektin e sipërpërmendur. Me shkresën Nr. 299 Prot, datë 02.03.2018 është dhënë rekomandim Titullarit mbi ankesën.Me shkresën Nr.317 Prot datë 02.03.2018 është kthyer përgjigje subjektit "Grup 4" shpk ndërsa me shkresën Nr.309 Prot datë 02.03.2018 i është kthyer përgjigje subjektit "Ankonda" shpk.Me marjen e përgjigjes nga Autoriteti Kontraktor, operatori ekonomik "Anakonda" shpk ka paraqitur ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke vënë në dijeni Autoritetin Kontraktor për këtë ankesë, sipas përcaktimeve të LPP-së.Në zbatim të nenit 63/8 të Ligjit Nr.9643, datë.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Anakonda" shpk pranë Komisionit të Prokurimit Publik Ak ka dërguar pranë KPP gjith dokumentaionin për procedurën e shoqëruar me CD me shkresën përcjellëse Nr.326 Prot date 12.03.2018Kpp dërgoi me vendimin Nr.429/1 Prot urdhëroi pezullimin e procedurën deri ne marrjen e vendimit.Më datë 07.05.2015 me shkresën Nr283/1 Prot u dërgua Vendimin Nr.283/2018 i datës 07.05.2018 duke vendosur: të kualifikojë operatorin ekonomik "Anakonda"shpk në adrese:Lagjia "18 Shtatori", se oferta e paraqitur me vlere 4,970,065.99 (katër milion e nëntëqind e shtatë dhjetë mijë e gjashtëdhjet e pesë pikë nëntëdhjet e nëntë) lek pa TVSH OSE për dy vendroje/DITORE 15 981.16 (pesëmbëdhjet mijë e nëntëqindë e tetëdhjet e një pikë gjashtëmbëdhjet) leke pa TVSHështë identifikuar si oferta e suksesshme. Më datën 16.05.2018 KVO-ja njoftoi njësinë e prokurimit për të bërë të perfunduar fazen e vleresimit te ofertave ne sistem duke i vënë në dispozicion edhe procesverbalin e vlerësimit të ofertave i cili bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.Kontrata me nr. 141E prot,date 28.05.2018 me fond 4.180.671 lekë me tvsh,për vitin 2018.



6.- AUDITIM I SISTEMIT TË KONTABILITETIT FINANCIAR

Kontabiliteti në Universitetin "Eqrem Çabej", mbahet në mënyre elektronike, ku edhe printohet sipas nevojave.

Grupi i auditimit ka konstatuar se:

- Janë bërë regjistrimi në ditar dhe në llogari i të gjithë veprimeve dhe fakteve ekonomike;
- Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare dhe pasurore dhe janë evidentuar e paraqitur në përputhje me standardet kontabile;
- Ka analizë të debi-kredive;
- Për çdo regjistrim është shkruar origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimeve ekonomike ose të ngjarjes;
- Mbahet cikli kontabël si, hapja e librave (regjistrimi në ditar dhe në librin e madh), përqendrimi i dokumentave justifikues, analiza e fakteve kontabile, regjistrimi në ditar i dokumentave justifikues, mbartja e regjistrimeve nga ditari në librin e madh, hartimi i bilancit vërtetues, kryerja e inventarizimeve, regjistrimet për përcaktimin e rezultatit, hartimi i bilancit përfundimtar;
- Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe planit kontabël

Nga auditimi i dokumentacionit bazë dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit, rezultojnë se veprimet janë regjistruar mbi bazën e dokumenteve justifikues që mbështesin regjistrimet kontabël dhe janë regjistruar në mënyrë kronologjike e sistematike, konformë Legjislacionit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Bilanci i vitit 2017 është dorëzuar brenda afatit ligjor, llogaria vjetore 2017, ka bashkëngjitur:

- Relacionin shpjegues për çdo zë të llogarisë;
- Situacionin e shpenzimeve për vitin 2017, të konfirmuar nga Dega e Thesarit ;
- Evidencën e Investimeve të konfirmuar nga Dega e Thesarit ;
- Evidencën e numrit të punonjësve për vitin 2017;
- Pasqyrën e lëvizjes së Fondeve;
- Evidencë të listës së Debitoreve .
- Pasqyrat Financiare Vjetore të Universitetit janë hartuar në zbatim të Legjislacionit në fuqi.


Plani i llogarive kontabël është në përputhje me Standardet e Kontabilitetit Publik. Lista e llogarive si dhe procedurat kontabile të tyre janë të ndërtuara sipas përcaktimeve të Standardeve të Kontabilitetit Publik, gjithashtu janë të përcaktuara në mënyrë të veçantë lista e llogarive dhe procedurat kontabël sipas specifikave të veçanta të Universitetit.

Për aktivet e qëndrueshme është llogaritur amortizimi sipas normave të përcaktuara ligjore. Është përcaktuar saktë detyrimi i buxhetit të shtetit ndaj institucionit për paga, sigurime e tatime që korrespondon me shumat përkatëse .

Nga kontrolli i debi kredive të vitit ushtrimor me vitin e mëparshëm, nuk ka diferencë. Shpenzimet janë regjistruar në mënyrë kronologjike dhe me saktësi, sipas akteve ligjore nënligjore dhe akteve normative në fuqi.

Situacionet e shpenzimeve dhe të ardhurave janë të firmosura e të konfirmuara në Degen e Thesarit. Dhënia e Opinionit për pasqyrat financiare.

Në kryerjen e auditimit jemi bazuar në Standardet e Auditimit të Brendshëm, të cilat kërkojnë veprime në përputhje me kërkesat etike, planifikimi dhe kryerjen e auditimit me qëllim të marrjes



së sigurisë së arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë deklarime të gabuara që janë materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim të sigurimit të dëshmive të auditimit në lidhje me shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare.

Dëshmitë e auditimit që kemi grumbulluar, besojmë se janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë të auditimit, i cili konsiston në: Pasqyrat financiare për vitin 2017, japin një pamje reale dhe të saktë të gjendjes së aktiveve të institucionit në mbyllje të ushtrimit, e për rrjedhojë i ofrojnë ndihmë menaxherëve në marrjen e masave për arritjen e objektivave.

7.- AUDITIM I SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm i kontrollit i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë një vjeçare, si dhe përdorimin me eficientë të tyre. Inventarizimi kryhet sipas procedurave të miratuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"

Nga auditimi është konstatuar:

- Me një urdhër të Administratorit janë ngritur tri komisione:
 1. Komisioni i inventarizimit i përbërë nga 3 anëtarë
 2. Komisioni i vlerësimit me 3 anëtarë
 3. Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi me 5 anëtarë
- Komisioni i inventarizimit ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit
- Komisioni i inventarizimit nuk ka përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e dëmtimeve apo të gjendjes funksionale të konstatuara, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Komisioni i vlerësimit nuk ka hartuar relacionin për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, ku sqaroheshin arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Rekomandojmë që, në procesin e inventarizimit të aktiveve, për vitin 2018, të mbahet parasysh evidentimi i gjendjes së aktiveve të konstatuara, të dëmtuara dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit të hartohet një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve dhe t'i dorëzohet për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues, si dhe të përgatitet relacioni për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, ku të sqarohen arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

Nga auditimi i veprimeve të magazinës për periudhën, rezultoi se:

- Të gjithë artikujt e blerë nga subjektet e ndryshme, dokumentoheshin me fletë hyrje;
- Fletë hyrjet dhe fletë daljet ruanin radhën e tyre kronologjike dhe numrin përkatës;
- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit ishte i bazuar në dokumentet origjinal;



Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente autorizues, vërtetues dhe dokumentet e kontabilitetit .

Vërtetohet saktësia dhe rregullariteti i dokumentimit të veprimeve të kryera me anë të magazinës, metodat e mbajtjes dhe të vlerësimit të inventarëve në kontabilitet si dhe masat e marra për ruajtjen e aseteve.

Për sa i takon ish shtëpisë së ushtarakëve nga auditimi rezulton:

Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë me V.K.M. Nr.752, datë 09.11.2006 "Për kalimin në përdorim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Shtëpisë së Oficerëve, Gjirokastrë" i është dhënë në përdorim për një afat 5-vjeçar kjo godinë për të përballuar zhvillimin normal të procesit mësimor.

Sipas këtij vendimi kemi të bëjmë me 1574 m² sipërfaqe ndërtimore dhe 6471 m² truall.

Mbështetur sa më lart është ngritur një komision i përbashkët i Universiteti dhe i Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë dhe me proces-verbalin e datës 30.12.2006, Universiteti mori në dorëzim objektin.

Nga ana e Shtëpisë së Ushtarakëve Dega Gjirokastrë, u liruan të gjitha ambientet e brendshme nga baza materiale.

Në atë periudhë nga universiteti është hartuar një projekt për rikonstruksionin e plotë të objektit, ku kujdes i është kushtuar si anës funksionale ashtu dhe asaj arkitektonike, që paraqitja e objektit të përmbushë pamjen e një Universiteti. Me gjithë kërkesat e vazhdueshme të universitetit drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si dhe Ministrisë së Financave në vitin 2009 u çel një fond pjesor për rikonstruksionin e godinës, në vlerën prej 3.000 mijë lekë, por nga universiteti nuk u ndërmorën procedurat e prokurimit kjo për faktin se në momentin që mbaron rikonstruksioni i objektit, Universitetit i mbaron afati i përdorimit.

Nga viti 2006 e në vazhdim universiteti paguan tri roje për ruajtjen e objektit.

Në vitet në vazhdim me Vendime të Këshillit të Ministrave për këtë pronë janë bërë disa ndryshime, e konkretisht:

1.- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.435, datë 16.06.2011 prona sa sipër i kalon në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Pasi sipas vkm nr.752, datë 9.11.2006 objekti është dhënë në përdorim për universitetin Eqrem Çabej për një afat deri në 5 vjet.

2.- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.680, datë 28.09.2016 ka kaluar në përgjegjësi administrimi kati i parë i ndërtesës me sipërfaqe ndërtimore 412 m² nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

Në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 16.06.2011 Ministrisë së Arsimit si përgjegjëse e administrimit të pronës "...i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 (Përdorim për zgjerimin e mjediseve mësimore e studimore...)", ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

Në dy raste ambientet janë dhënë me qira për të tretë si dhe sipërfaqia truall shfrytëzohet pa pagesë nga një qerramarës dhe pjesa tjetër parking i lirë për qytetarët e Gjirokastrës

Aktualisht gjendja fizike e objektit është shumë e amortizuar dhe mjediset sipas projektit ekzistues (2009) jo të përshtatshme për funksionin e ri, pasi nuk plotësojnë kushtet për të shërbyer si auditor, sala leksioni, laborator, klasa seminari, etj.

8.- AUDITIM I SISTEMIT MBI PËRDORIMIN E FONDEVE PËR BURSAT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" dhe në zbatim të Vendimit të Bordit të Administrimit janë shqyrtuar dhe miratuar bursat për studentët.



aktualisht studentët që përfitojnë bursë :

Nr	VITI 2017-2018	Burse e plote	Burse 50 %	Te konvertuara
1	VITI I	20	37	38.5
2	VITI II	17	30	32
3	VITI III	16	12	22
	SHUMA	53	79	92.5

Pra janë
132

trajtuar
studentë

për 92.5 bursa nga të cilat 53 bursa të plota dhe 79 bursa 50%.

Për përfitimin e bursave në dosje u gjet një praktikë e rregullt dokumentare si nga administratori dhe Bordi i administrimit (Dokumente të cilat janë pjesë e dosjes së auditimit).

Me shkresën nr 1380 Prot. date 06.12.2017 ka dalë urdhëri i Administratorit për ngritjen e komisionit të vlerësimit të bursave në mbështetje të vkm nr 903 datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore ,për studentët e shkëlqyer ,studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe tudentë në nevojë" të ndryshuar me V.K.M. Nr 450 fatë 22.05.2017.Më datën 22.12.2017 është mbajtur proces verbali ku përcakton se për vitin akademik 2017-2018 janë përllogaritur plan 82 bursa .Nga dokumentacioni u përfituan 46.05 bursa .Në datën 22.12.2017 materiali u kalua në Bordin e Administrimit dhe u miratuan 46.05 bursa me nr vendimi 22 të Bordit dhe 1471Prot datë 26.12.2017, për për arsye se afati i mbledhjes së dokumentacionit ishte shumë i shkurtër komisioni vendosi qe disa studentë që kishin ndonjë mangësi në dokumentacion të shqyrtoheshin me dokumentat e studentëve të vitit të parë ku ishin përftues edhe për 7.5 bursa për studentët e viteve të ndërmjetme.Për studentët e vitit të parë dokumentacioni nga rrethet ka ardhur ne vazhdimësi sipas rretheve është grumbulluar e trajtuar nga komisioni dhe në vazhdim është miratuar nga Bordi i Administrimit më datën 04.04.2018 me vendimin nr 6 të Bordit dhe 409 Prot datë 04.04.2018.datë 14.05.2017 me vendim nr 14 datë 14.05.2018 dhe 675Prot janë miratuar edhe një bursë për studentë që erdhën më vonesë nga rrethet .

Një kopje e listës emërore të studentëve sipas masës së përfitimit të bursës e nënshkruar nga Komisioni dhe miratuar nga titullari qëndron në dosjen e bursave dhe një kopje I ka kaluar zyrës së Financës për kryerjen e veprimeve për likuidimin e studentëve.

Rezulton se pagesat në muaj janë bërë të rregullta ,dhe në asnjë rast nuk janë kryer pagesa pa u dhënë konfirmimi I Dekanit të fakultetit përkatës për frekuentimin e studentëve përfitues të bursës , në procesin mësimor .Konfirmim për mosfrekuentim sipas muajve është dhënë nga Njësitë bazë .

9.- AUDITIM I SISTEMIT MBI KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE

Plani i grumbullimit të të ardhurave dhe fakti i realizimit të tyre për vitin 2017 u bazua në:

- programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor),
- programet e studimit të ciklit të dytë (MP e MSH),
- numrin e studentëve për çdo program studimi,
- nivelin e tarifave të vendosura me VKM për çdo program studimi

Realizimi i këtij plani është si rezultat:

Në zërat e të ardhurave peshën kryesore e zënë:

- tarifat e shkollimit, grumbullimi i të cilave është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria ekonomike dhe fakultetet. Këto të ardhura përbëhen nga:



-tarifa e shkollimit në Bachelor me kohë të plotë

-tarifa e shkollimit në Ciklin e dytë të studimeve Master profesional dhe Master shkencor

-Libreza e diploma

-Taksë regjistrimi

-Shërbime të ndryshme ndaj studentëve dhe të tretë.

Në realizimin e të ardhurave kanë ndikuar edhe efekte në ulje:

- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit, në zbatim të VKM -ës dhe Vendimit të BA – së për përjashtim nga pagesa e tarufës së shkollimit të studentëve të Ciklit të parë të studimeve Bachelor me kohë të plotë. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës të plotë i tarifës së shkollimit. Sipas aplikimeve të kryera nga studentët për këtë qëllim
- Mos shlyerja në kohë e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve.
- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi. Për këto programe ishte planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.

Studentë të përjashtuar nga tarifa e shkollimit

Nr	Viti akademik	Totali i studenteve	Bachelor	Master profesional	Master shkencor	Shuma lekë
1	2016-2017	91	64	23	4	2.579.539
2	2017-2018	132	120	12	0	2.940.000

Të ardhurat janë çelur për përdorim sipas ndarjeve në Buxhetin e vitit 2017 për Universitetin, mbështetur në domozdoshmërinë për shpenzim për çdo artikull dhe kontratave të lidhura e të realizuara në investime e shpenzime operative, si dhe për shpenzime të tjera korente.

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE PER VITIN 2017

Nr	Lloji i të ardhurave	Viti 2017
1	Qera	265.400
2	Tarifa Shkollimi	47.776.565
3	Libreza e diploma e Vërtetime . tjera	318.000
6	Tarife regjistrimi	3.090.000
	SHUMA	51.449.965

Fakti I të ardhurave 2017

Nr	Lloji i të ardhurave	Viti 2017
1	Qera	96.000
2	Tarifa Shkollimi	45.063.000
3	Libreza e diploma e Vërtetime . tjera	4525
6	Tarife regjistrimi	4.000
	SHUMA	49.688.825

Përdorimi I të ardhurave 2017

Nr	Emërtesa e shpenzimeve	Viti 2017		
		Limiti i perdorimit (miratuar nga KA)	Realizimi	% real. Me plan.fill



1	Fondi i pagave	20.000.000	16.354.026	82%
2	Shpenzime Operative	20.704.000	7.469.872	36%
3	Investime	12.318.400	646.800	5%
4	Studime projektme	2.961.600	198.342	6%
	Totali	55.984.000	24.669.040	44%

Sic shihet edhe nga tabela e mësipërme për vitin 2017, të ardhurat janë realizuar në vlerën 49.688.825 lek gjithsej, nivel ky më i ulëti në këto vitet e fundit.

Duke analizuar të ardhurat e realizuara të Universitetit gjatë viteve të fundit ato janë ulur, në një masë të konsiderueshme, pavarësisht nga hapja e programeve të studimit "Master Profesional" dhe "Master Shkencor", sepse pothuajse në të gjitha programet e studimit të Universitetit, numri i studentëve të regjistruar ka ardhur në ulje. Ulja e ndjeshme e të ardhurave vjen si pasojë edhe e faktit që një pjesë e tarifës së shkollimit të studentëve është arkëtuar që në muajt nëntor–dhjetor 2016, sepse ishte përcaktuar me V.K.M. arkëtimi i 30% të tarifës së shkollimit të studentëve që në momentin e regjistrimit. Një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave vjen nga arkëtimi i tarifës së provimeve të prapambetura nga studentët e Masterit Profesional dhe Shkencor, të cilët nuk mbarojnë studimet brenda afatit kohor të përcaktuar në legjislacion (1.5 vjet ose 2 vjet) dhe paguajnë për cdo provim sipas krediteve përkatëse. Kjo vlerë krijon një masë të qëndrueshme të përvitshme në nivelin e të ardhurave, kurse sistemi part-time është tkurrur totalisht dhe të ardhurat e realizuara nga ky program studimi për vitin 2017 ishin minimale. Një faktor i cili ndikon negativisht në rritjen e të ardhurave është trajtimi i një numri të madh studentësh, të cilët vijnë nga shtresa sociale në nevojë, me prindër invalid ose të përndjekur politik etj dhe nuk e paguajnë ose e paguajnë pjesërisht tarifën e shkollimit sipas sistemit të studimit përkatës.

Plani i limitit të përdorimit nga të ardhurat dytësore për vitin 2017 në total është 55.984.000 lekë, nga i cili është realizuar në vlerën 24.669.040 lekë, përfshirë ndryshimet e herëpashërëshme (të cilat janë miratuar rast pas rasti nga Bordi i Administrimit) ku të detajuar sipas artikujve të shpenzimeve i analizojmë më poshtë:

I- Financimi nga të ardhurat dytësore në zërin e pagave

ka përfshirë pagesën e orëve të pedagogëve të ftuar, orët jashtë kohës normale të punës, orët suplementare deri në 30 %. Me fondin e mësipërm të pagave janë mbuluar të gjitha shpenzimet sipas shkresave të ardhura nga Dekanatet dhe Departamentet për të gjithë punonjësit efektiv dhe ata të jashtëm për vitin 2017. Ka një mosrealizim tek ky zë, pasi në fondin e planifikuar në fillim të vitit është planifikuar të likuidohen edhe orët e realizuara mbi 30% të ngarkesës mësimore, por me miratimin e tyre në senat dhe në Bordin e Administrimit këto orë janë paguar nga buxheti i shtetit dhe jo nga të ardhurat e Institucionit, bazuar edhe në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

II-Financimi nga të ardhurat dytësore për shpenzimet operative:

Fondi për shpenzimet operative është planifikuar nga të ardhurat e institucionit në masën 20.704.000 lekë lekë në total, ku gjatë vitit janë bërë rialokime të ndryshme, brenda limitit të përdorimit të të ardhurave të miratuara në fillim të vitit, të cilat janë miratuar në BA-në e Universitetit dhe të detajuara jepen në Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve Publike.

Brenda limitit të celur në fillim të vitit, duke parë realizimin e pritshëm të shpenzimeve janë bërë rialokimet përkatëse kryesisht për ato zëra të cilat nuk kishte planifikim paraprak dhe nuk kishin ndonjë kërkesë në fillim të vitit.

Të gjitha këto rialokime janë dërguar për miratim në BA-në dhe janë miratuar me vendimet përkatëse, duke i pasqyruar në Regjistrin e Parashikimeve Publike, të ndryshuar, ku janë njoftuar edhe Zyra e Prokurimeve pranë MAS-it edhe Dega e Thesarit Gjirokastrë.



shpenzimet sipas zërave të detajuara janë dhënë tek tabela e Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve. Në tabelë është dhënë planifikimi dhe realizimi sipas zërave me gjithë ndryshimet përkatëse të miratuara gjatë vitit nga Bordi i Administrimit.

Nga zëri i shpenzimeve operative u financuan shpenzimet për kontratat e prokuruar dhe për shpenzimet me blerje të vogël, ku për arsye se janë planifikuar nga të ardhurat e institucionit, i është dhënë një rëndësi të vecantë efektivitetit të tyre, me qëllim realizimin e shpenzimeve më të domosdoshme për të mbajtur një rezervë që është e trashëgueshme për vitin në vazhdim.

Realizimi i shpenzimeve operative është në vlerën afërsisht 44 % nga të ardhurat.

Bie në sy fakti numri i lartë dhe shuma e konsiderueshme e tarifës se shkollimit e paarkëtuar.

Studentët Aktualë Bachelor që nuk kanë paguar tarifën e shkollimit për Vitin Akademik 2017-2018 janë sipas tabelës në dosje

Janë gjithsej pa paguar 153 studentë të bachelorit me një vlerë prej 3.654.500 lekë

Përkatësisht :

Në Fakultetin Ekonomik që nuk kanë paguar tarifën janë 66 studentë në shumën 1.502.500 lekë

Në F.E.SH.SH janë 39 studentë me vlere prej 1.142.500 lekë

Në FSH.N janë pa paguar 48 studentë me një shumë prej 1.009.500 lekë.

Studentët e listës nuk kanë frekuentuar studimet .

Studentet ne master janë në proces likuidimi për arsye se pagesa e tyre bëhet me këste në bazë të shkresës së Administratorit nr 1318 prot datë 22.11.2017 e miratuar në Bordin e Administrimit me vendimin nr 20 e nr 1169 prot datë 07.11.2017.

Studente debitore të arkëtueshëm ne master jane :

F. E. 53 studente me vlere 490.000 LEKE

Fesh sh 15 studente me vlere 155.000 leke te pa arketuar

FSH.N 7 studente 70.000 leke te pa arketuar

- Ambientet e dhëna me qira për vitin 2016-2017

NR		KONTRATA	QERA MUJORE	Periudha	PËRDORIMI	SIPËRFAQJA
1	Berti Llakaj	nr 884 prot date 02.10.2017	7.040	02.10.2017-01.10.2018	BAR KAFE	64M2 NDERTESE 32 M2 FUNKSIONALE
2	Jorgo Llukani	nr 931 prot.dt10.10.2017	11.000	10.10.2017-09.10.2018	BAR KAFE	100 M2 NDERTESE 50 M2 FUNKSIONALE
3	Anakonda	Nr1026 prot.dt.27.10.2017	5.500	02.10.2017-30.09.2018	DHOMA QENDRIMI PER R.CIVILE	55 M2 NDERTESE

Ambjentet janë dhënë me qera pas miratimit nga Bordi i Administrimit me vendimin nr 18, me nr 813 Prot .datë 15.09.2017.

Në ish shtëpinë e ushtarakëve pronë në përgjegjësi administrivë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë janë dhënë dy ambiente me qira, përkatësisht për Jorgo Llukani me objekt "Bar kafe" dhe Shoqërisë private të ruajtjes fizike "Anakonda" për dhoma qëndrimi për roje". Kjo në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 16.06.2011, sipas së cilës Ministrisë së Arsimit si përgjegjëse e administrimit të pronës "...i ndalohej të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 (Përdorim për zgjerimin e mjediseve mësimore e studimore...)" të tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

Në dy raste ambientet janë dhënë me qira për të tretë si dhe sipërfaqja truall shfrytëzohet pa pagesë nga një qerramarës dhe pjesa tjetër parking i lirë për qytetarët e Gjirokastrës.

Ambienti i dhënë më qira me objekt "Bar Kafe" në ish godinën e ushtarakëve, prej disa vitesh, nga auditimi në vënd rezulton se nuk ka ndonjë objekt në këtë godinë për "Bar kafe"



10.- AUDITIM I SISTEMIT TË NGARKESAVE MËSIMORE

Në zbatim të kërkesave të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë" Rektori i universitetit ka nxjerrë një udhëzim të brendshëm për realizimin e normës së ngarkesës dhe orëve mbi normën e ngarkesës.

Në zbatim të këtij udhëzimi evidencat për plotësimin e orëve të mësimi të firmosura nga pedagogu u lëndës, përgjegjësi i departamentit dhe dekani janë dorëzuar në fund të semestrit dhe në ndonjë rast në fund të vitit akademik, pas përfundimit të programit lëndor të disiplinës.

Të dhënat për realizimin e normës për pedagogët e brendshëm dhe realizimi i orëve për pedagogët e jashtëm janë sipas pasqyrave në dosje.

Pagesa e orëve mbi normën e ngarkesës dhe për pedagogët e jashtëm është bërë nga të ardhurat e universitetit.

Në lidhje me pagesën e mbingarkesës mësimore për vitin 2016-2017 janë marrë në konsideratë evidencat e mësimdhënies nisur nga Fakultetet.

Dokumentat që janë paraqitur nga departamentet janë:

1. Marrëveshja e lidhur në fillim të vitit akademik ndërmjet pedagogut dhe shefit të departamentit.

2. Evidencat personale të pedagogëve.

3. Evidencat përmbledhëse të Departamentit me të gjithë elementët e mësimdhënies.

Bazuar në udhëzimin nr.20 është paguar mbingarkesa deri në masën 30% të ngarkesës së normuar vjetore Kjo pagesë është bërë nga të ardhurat e Institucionit.

Bazuar në udhëzimin nr.20 është paguar mbingarkesa deri në masën 30% të ngarkesës së normuar vjetore Kjo pagesë është bërë nga të ardhurat e Institucionit.

Në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr.20, sipas shkresës nr.1065/5, datë 18.08.2017 dhe vendimit të bordit të administrimit nr.18, datë 15.09.2017 është miratuar pagesa e dhënies të mbingarkesës deri 100 % të realizimit të normës. pa marrë më parë miratimin nga Ministri i Arsimit, siç përcakton udhëzimi.

Paraprakisht Universiteti I është drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.1187, datë 09.11.2017 dhe përgjigjia e MASR me shkresën datë 22.11.2017 (Pjesë e dosjes) konkludon se: "Për sa më sipër të gjitha pagesat duhet të realizohen pas miratimit nga Bordi I Administrimit të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër".

Të dhënat për realizimin, tejkalimin dhe pagesën e orëve mbi normën e ngarkesës janë sipas pasqyrës në dosjen e auditimit.

Opinion i Përgjithshëm.

Në universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër sistemet e kontrollit të brendshëm në tërësi veprojnë drejt.

GRUPI I AUDITIT

Skënder Jaku

Jeton SHEHU

Tiranë, më _____ 2018



**Plan veprimi
për zbatimin e rekomandimeve nga Universiteti "Eqrem Çabej",
Gjirokastrë**

Nr	Rekomandim	Renditja sipas nivelit	Reagimi i menaxhimit të subjektit	Afati i përcaktuar	Personi përgjegj.
1	Te meren masa urgjente për të vënë në efijencë ish godinën e ushtarakëve,	I lartë	I pranuar		
2	Për pagesën e orëve mbi normën e ngarkesës Në zbatim me kërkesat e udhëzimit nr.20, bordit administrimit për tejkalimin e normës së ngarkesës mbi 30 % të marrë vendim pas miratimit nga Ministri I Arsimit,	I lartë	I pranuar		
3	Në ish shtëpinë e ushtarakëve pronë në përgjegjësi administrative e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë menjëherë të rishikohet kontratat për dy ambiente me qira, pasi janë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 16.06.2011, sipas së cilës Ministrisë së Arsimit si përgjegjëse e administrimit të pronës "...i ndalohej të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 (Përdorim	I lartë	I pranuar		



	për zgjerimin e mjediseve mësimore e studimore...”), ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve. Në dy raste ambientet janë dhënë me qira për të tretë si dhe sipërfaqja truall shfrytëzohet pa pagesë nga një qiramarrës dhe pjesa tjetër parking i lirë për qytetarët e Gjirokastrës.				
4	<i>Të kihet parasysh evidentimi i gjendjes së aktiveve të konstatuara, të dëmtuara. Në përfundim të inventarizimit të përpilohet një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve dhe t’i dorëzohet për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues, si dhe të përgatitet relacioni për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, ku të sqarohen arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.</i>	I mesëm	I pranuar		
5.	<i>Të meren në kohë masat organizative për realizimin e fondeve për investime.</i>	I mesëm	I pranuar		



ADMINISTRATORI

REKTORI

Gentian Llogo



Reagim nga subjekti i audituar

Subjekti i audituar:	Universiteti "Eqrem Çabej"
Angazhimi i auditimit:	Nr.6039/1 prot, datë 11.06.2018
Data e raportimit:	më 17.08.2018

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet tuaja, për të na ndihmuar të vlerësojmë performancën tonë personale dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë.

Duke përdorur shkallën e vlerësimit si më poshtë, ju lutem rrethoni numrin në kolonën e djathtë që reflekton pikëpamjet tuaja në punën tonë, në secilën nga fushat e përmendura.

Shkalla e vlerësimit

(1) – Shumë të kënaqur (2) – Të kënaqur (3) – Të pakënaqur (4) – Shumë të pakënaqur

Nr.	Komponentët e përfomancës (Sa të kënaqur jeni)	1	2	3	4	Komente
I	Planifikimi i Auditimit					
1	Ju janë dhënë mundësi të përshtatshme për të rënë dakord në fushë veprimin e auditimit para se të fillonte?					
2	Ju është dhënë njoftimi i duhur për kohën dhe kohëzgjatjen e auditimit?					
II	Kryerja e auditimit					
3	Audituesit e brendshëm kanë qenë profesionalë dhe të sjellshëm gjatë kryerjes së auditimit?					
4	Audituesit e brendshëm kishin njohuri të mjaftueshme në fushën e veprimtarisë suaj?					
5	A ju është komunikuar në mënyrën e duhur progresi i angazhimit të auditimit, duke përfshirë detajet e çështjeve kryesore që u shqyrtuan?					
III	Raportimi i rezultateve të auditimit					
6	Projekt raporti është marrë Brenda një kohe të pranueshme të parashikuar?					
7	Projekt raporti është prezantuar në mënyrë të qartë ne lidhje me formatin dhe qartësinë e gjuhës së përdorur?					
8	Pas përgjigjeve të menaxhimit për komentet, raporti përfundimtar është marrë Brenda një kohe të pranueshme të parashikuar?					



9	Rekomandimet afruan zgjidhje praktike dhe konstruktive për çështjet e identifikuar?					
10	Argumentimi për gjetjet dhe përfundimet e auditimit a janë shpjeguar në mënyrë të kënaqshme?					
IV	Cilësia e auditimit të brendshëm					
11	Zbatimi i rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të risqeve, të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes?					
12	Auditimi ju afroi informacionin që do t,ju ndihmojë për të përmbushur përgjegjësitë e raportimit tuaj të sigurimit të cilësisë?					
13	A kontribuon auditimi i brendshëm në përmirësimin dhe arritjen e objektivave strategjike të organizatës Tuaj?					
V	Shërbime të tjera të ofruara nga auditimi i brendshëm					
14	A jeni të vetëdijshëm se njësi e auditimit të brendshëm ofron shërbime këshillimi?					
15	Nëse ju keni përdorur shërbimet e këshillimit të ofruara nga auditimi i brendshëm, a jeni të kënaqur me kontributin e dhënë?					

Ps: Në qoftë se jepet një vlerësim 3 ose 4, ju lutem jepni më shumë hollësi në seksionin "Komente" në mënyrë që ne të mund të marrim parasysh si mund të përmirësohemi.

Drejtuesi i Institucionit

